



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOLEGJI ZGJEDHOR GJYQËSOR  
TIRANË

Nr.3 Regj.Them.  
Datë Rregj.27.02.2023

Nr. 3 VENDIMI  
Datë 09.03.2023

**V E N D I M**  
**“NË EMËR TË REPUBLIKËS”**

Kolegji Zgjedhor Gjyqësor i mbledhur pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë me trup gjykues të përbërë nga:

Gjyqtare: **Edlira PETRI** (*Relatore*)  
Gjyqtare: **Blerona HASA** (*Anëtare*)  
Gjyqtare: **Esmeralda XHILI** (*Anëtare*)  
Gjyqtare: **Manjola XHAXHO** (*Anëtare*)  
Gjyqtare: **Marsela DERVISHI** (*Anëtare*)

me sekretare gjyqësore Ermelinda Nuraj, sot më datë 09.03.2023, në seancë gjyqësore me dyer të hapura, mori në shqyrtim çështjen me nr.3 akti, datë 27.02.2023 që i përket:

**PADITËS:** **Partia Lëvizja për Zhvillimin Kombëtar**, përfaqësuar nga Kryetari i partisë Z.Dashamir Shehi me adresë: Rr “Andon Z.Çajupi” Tiranë, përfaqësuar me autorizim datë 02.03.2023 nga Z.Rizaldo Vrenozi.

**TË PADITUR:** **-Komisioni i Ankesave dhe i Sanksioneve.**  
**-Komisioni Qendror i Zgjedhjeve**, të përfaqësuar në gjykim me autorizim nr. 1480 Prot datë 08.03.2023 nga Z.Erdal Mema.

**OBJEKTI:** Ndryshimin e Vendimit të Komisionit të Ankesave dhe Sanksioneve nr. 07, datë 25.01.2023, për shqyrtimin e kërkesës nr. 04, datë 14.12.2022 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve duke vendosur rrëzimin e kërkesës së Komisionerit për subjektin politik LZHK.

**BAZA LIGJORE:** Neni 145 e vijues i Kodit Zgjedhor të RSH.

Kolegji Zgjedhor, në seancën e datës 09.03.2023, pasi dëgjoi pretendimet e fundit të palës paditëse që kërkoi pranimin e padisë sipas objektit, si dhe palës së paditur që kërkoi rrëzimin e padisë,

## **VËREN:**

1. Se pala paditëse, subjekti Partia Lëvizja për Zhvillimin Kombëtar i është drejtuar Kolegjit Zgjedhor, duke depozituar pranë Gjykatës Administrative të Apelit, padinë me objekt *“Ndryshimi i vendimit nr. 7, datë 25.01.2023 të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve (KAS) në Komisionin Qëndror të Zgjedhjeve duke vendosur rrëzimin e kërkesës së Komisionerit për subjektin politik LZHK”*. Referuar përcaktimeve të Kodit Zgjedhor, brenda afatit ligjor, u caktua seanca për gjykimin e kërkesëpadisë së paraqitur, duke iu kërkuar edhe palës së paditur paraqitja e të gjithë dokumentacionit përkatës, lidhur me vendimmarrjen që kundërshtohet nëpërmjet kësaj kërkesëpadie.

### **I. FAKTET E ÇËSHTJES:**

2. Në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, pas përfundimit të procesit zgjedhor për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 25 prill 2021, në zbatim të nenit 92/6 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, *“Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”* dhe Vendimit nr. 426, datë 12.07.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, *“Për shpalljen e rezultatit të shortit për fushatën zgjedhore”*, caktoi ekspertët kontabël të licensuar (auditues ligjor) për auditimin e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nga partitë politike për fushatën zgjedhore.

3. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve në përfundim të auditimit të fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nga partitë politike ka miratuar raportin e gjetjeve nga auditimi i fondeve të përfituara dhe shpenzuara nga partitë politike pjesëmarrëse në zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, të datës 25.04.2021.

Konkretisht në raportin e gjetjeve nga auditimi të fondeve të përfituara dhe shpenzuara nga partitë politike pjesëmarrëse në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 25 prill 2021, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve konstaton se:

*“.. janë 13 (trembëdhjetë) parti politike, të cilat nuk i kanë dorëzuar raportet financiare në përputhje me nenin 92/3 e në vijim të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar si dhe vendimit nr. 13, datë 6.04.2021, “Për përcaktimin e rregullave për raportimin financiar të subjekteve zgjedhore, kontrollin dhe verifikimin e financimeve dhe shpenzimeve të tyre gjatë fushatës zgjedhore”, të Komisionit Rregullator, si më poshtë vijon:*

*1. ....;*

**9. Lëvizja për Zhvillimin Kombëtar”** nuk ka dorëzuar raportin për 1 (një) kandidat të listave shumëpartore duke mos respektuar vendimin nr. 13, datë 6 prill 2021, të Komisionit Rregullator dhe për këtë arsye nuk janë audituar raportet e kandidatëve. Referuar nenit 173, pika 3, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, *“Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”*, i ndryshuar ..... *“Paraqitja e raporteve në shkelje të rregullave dhe formateve të standardizuara të miratuara nga KQZ-ja dënohet me gjobë në vlerën 500.000 (pesëqind mijë) deri 1 000 000 (një milion) lekë;*

- Ka kryer shpenzime për fushatën pa dokumentacion justifikues në shumën prej 325.000 leke, prej të cilave 150.000 leke janë pa paguar akoma. Referuar nenit 173, pika 1, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, “... Shkelja e dispozitave për financimin e fushatës zgjedhore nga personi përgjegjës i financës së një partie politike dënohet me gjobë në vlerën 100 000 (njëqind mijë) deri në 200 000 (dyqind mijë) lekë”.

4. Në vijim Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e zhvilluar në datë 03.11.2022, verifikoi se KRIIK, nëpërmjet e-mail-it, dërgoi konstatimet e bëra për subjektet zgjedhore për fushatën zgjedhore të datës 25 prill 2021, ku ndër to edhe për Partinë Lëvizja për Zhvillimin Kombëtar.

Konstatimet e KRIIK për Partinë Lëvizja për Zhvillimin Kombëtar:

“- raporti është dorëzuar në KQZ në tejkallim të afateve ligjore;

- mungon bilanci i asetëve dhe detyrimeve”.

5. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve pas marrjes së informacionit nga KRIIK, u dërgoi e-mail për konstatimet e tyre për 19 (nëntëmbëdhjetë) parti politike. Subjektet zgjedhor, të cilave u dërgua e-mail-i kanë kthyer përgjigje 14 (katërmëdhjetë) subjekte zgjedhore ku ndër to është dhe Partia Lëvizja për Zhvillimin Kombëtar.

Partia Lëvizja për Zhvillimin Kombëtar në e-mail përgjigjet se:

“Nuk ka pasur ndryshime financiare për periudhën zgjedhore nga ai i bilancit Financiar të vitit 2021, ku janë të përfshira asetet dhe detyrimet”.

6. Me Vendimin nr. 224 datë 07.12.2022 Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vendosi:

“1. Miratimin e gjetjeve të raportit të auditimit të fondeve të përfituara dhe shpenzuara nga partitë politike pjesëmarrëse në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 25 prill 2021, sipas shtojcës nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

.....

4. T’i propozojë Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve marrjen e masës administrative, për financierin e partisë politike “Lëvizja për Zhvillim Kombëtar”, me gjobë në masën 100 000 (njëqind mijë) lekë, sipas nenit 173, pika 1 të Kodit Zgjedhor;

9. T’i propozojë Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve marrjen e masës administrative, për partinë politike “Lëvizja për Zhvillim Kombëtar” me gjobë në masën 500 000 (pesëqind mijë) lekë, sipas nenit 173, pika 3 të Kodit Zgjedhor;

20. Detyrimin e partisë politike “Lëvizja për Zhvillim Kombëtar” të kthejë në KQZ shumën prej 55.166,74 (pesëdhjetë e pesë mijë e njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë presje shtatëdhjetë e katër) lekë, sipas nenit, 88 pika 7 të Kodit Zgjedhor”.

7. Me marrjen e Vendimit nr. 224 datë 07.12.2022, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve i është drejtuar Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve, me kërkesën nr. 4 datë 14.12.2022 për vendosje sanksioni administrativ për shkeljet e konstatuara nga subjekte zgjedhore për zgjedhjet e Kuvendin e Shqipërisë, datës 25.04.2021 ku është edhe pala paditëse Partia Lëvizja për Zhvillimin Kombëtar.

8. Në seancën e datës 16.01.2023, Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve mori në shqyrtim kërkesën e Komisionerit, të prezantuar nga z. Ylli Merkaj, Sekretar i Përgjithshëm i KQZ-së, në

prani të përfaqësuesve të palëve të interesuara; Partia Nisma Thurje, Partia Lëvizja për Zhvillim Kombëtar, Partia Bashkimi Popullor i Pensionistëve Shqiptar, Partia Bindja Demokratike, Partia Balli Kombëtar, Partia Demokristiane e Shqipërisë, Partia Lëvizja e Legalitetit, Partia Social Demokrate, Partia Republikane.

9. Sekretari i Përgjithshëm i KQZ-së kërkoi miratimin e kërkesës së Komisionerit. Përfaqësuesi i Partisë Lëvizja për Zhvillimin Kombëtar kërkoi rrëzimin e kërkesës.

10. Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në përfundim të hetimit administrativ, me vendimin nr. 7, datë 25.01.2023, bazuar në nenet 21, pika 1, shkronja ‘dh’, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendosi:

1. *Pranimin e pjesshëm të kërkesës së Komisionerit për vendosjen e sanksioneve administrative ndaj subjekteve zgjedhore dhe kandidatëve për shkelje lidhur me raportimin financiar.*

2. *Vendosjen e sanksionit administrativ në masën 500.000 (pesëqindmijë) lekë, sipas nenit 173, pika 3, të ligjit 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar” për subjektet zgjedhore:*

- Partia Socialiste;
- Partia Demokratike;
- Lëvizja për Zhvillim Kombëtar;
- Lëvizja e Legalitetit;
- Bashkimi Popullor i Pensionistëve Shqiptarë;
- Nisma Thurje;
- Bindja Demokratike;
- Partia Socialdemokrate;
- Balli Kombëtar;
- Balli Kombëtar Demokrat.

3. ....

4. *Vendosjen e sanksionit administrativ në masën 100.000 (njëqind mijë) lekë, sipas nenit 173, pika 1, të ligjit 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar” për subjektet zgjedhore:*

- Partia Demokristiane e Shqipërisë;
- Lëvizja për Zhvillim Kombëtar.

5. ....

9. *Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.*

10. *Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Administrativ, Tiranë brenda 30 ditëve nga shpallja e tij”.*

#### **Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve ka arsyetuar:**

1. *Tipologjia e shkeljeve të konstatuara nga Komisioneri për 14 subjekte zgjedhore dhe 1 kandidat, për të cilët kërkon vendosjen e sanksionit administrativ përmbledh mosdorëzimin e raporteve të të ardhurave dhe shpenzimeve nga një numër kandidatësh të subjekteve, mosbashkëpunimin ose refuzimin për të bashkëpunuar me KQZ-në lidhur me raportimin, mungesën e dokumentacionit shoqëruar për shpenzimet, raportimin jo sipas formatit të*

standardizuar si dhe kapërcimin e limiteve ligjore në kryerjen e shpenzimeve dhe pranimin e donacioneve.

2. Palët e interesuara pjesëmarrëse në seancë ngritën dy pretendime kryesore për të justifikuar shkeljet e konstatuara, pretendimin se mungesa e raportimeve për kandidatët vjen për shkak se kandidatët nuk kanë pasur shpenzime (në rastin e partisë politike “Nisma Thurja”, për shkak se nuk kanë kryer fushatë), si dhe pretendimin se për partitë pjesëmarrëse në koalicion nuk mund të vendosen sanksione administrative, sa kohë që detyrimi për raportim i takon partisë udhëheqëse të koalicionit 3. Trajtimi i këtyre pretendimeve ka shumë rëndësi për zbatimin e rregullt dhe uniform të Kodit Zgjedhor.

4. Fushata zgjedhore është e lidhur pazgjidhshmërisht me kryerjen e shpenzimeve për veprimtaritë në fushatë. Të gjitha veprimtaritë kanë kosto, e cila duhet të evidentohet dhe të raportohet si shpenzim si kur mbulohet nga vetë kandidati ose subjekti zgjedhor nga të ardhurat e veta, si kur mbulohet nga financimi buxhetor, si kur mbulohet nga donacionet në të holla ose në natyrë.

5. Kodi Zgjedhor ka adoptuar një mekanizëm pariteti proporcional dhe mbështetjeje financiare për subjektet elektorale, me qëllimin që të lehtësojë barrën e shpenzimeve dhe ta bëjë garën sa më të barabartë. Por, që të ruhet barazia në konkurrim duhet që kontrolli dhe mbikëqyrja e zbatimit të rregullave për financimin e fushatës të jetë i hollësishëm dhe i rreptë. Për këtë arsye ka shumë rëndësi që raportimi, rregullshmëria, saktësia dhe vërtetësia e tij të jenë të garantuara dhe të pacënueshme. Shkeljet në raportim, fshehja e të ardhurave dhe shpenzimeve, cënimi i kufijve ligjorë lidhur me masën e të ardhurave dhe shpenzime përbëjnë, në këndvështrim të Kodit Zgjedhor, kundravajtje të rënda. Ndryshimet e fundit të Kodit Zgjedhor kanë synuar pikërisht forcimin e disiplinës financiare dhe transparencën e raportimit, në mënyrë të veçantë nëpërmjet forcimit të sanksioneve. Kjo rreptësi duhet të karakterizojë edhe KQZ-në në trajtimin e këtyre rasteve.

6. KAS-i çmon se pretendimi për fushatë të kandidatëve “pa shpenzime” është një pretendim jo real, i cili mund të vijë nga padija, paaftësia për të ruajtur disiplinë financiare apo për të organizuar siç duhet punën, por mund të vijë edhe si tentativë për mosraportim të saktë, për fshehje apo devijim të një pjese të të ardhurave dhe shpenzimeve në kanale informale, apo si shmangie nga tavanet ligjore etj. Pavarësisht nga motivet, pretendimi për kandidatë “pa shpenzime” nuk mund të pranohet nga KAS-i, sepse një pretendim i tillë është de facto i pavërtetë.

7. Në themel të zgjedhjeve demokratike qëndron parimi i konkurrueshmërisë. Makina administrative e zgjedhjeve ngrihet dhe mbahet në këmbë pikërisht për t'i shërbyer këtij parimi. Parimi i konkurrueshmërisë kërkon që të mos ketë kufizime në të drejtën për të marrë pjesë në garë dhe që garuesit të jenë të barabartë me njeri tjetrin.

8. Kushtet dhe kriteret e vendosura për t'u plotësuar nga subjektet zgjedhore janë proporcionale dhe nuk e cënojnë konkurrueshmërinë. Prandaj respektimi ose jo i tyre nga subjektet dhe kandidatët nuk mund të trajtohet si çështje e vulletit të tyre të lirë dhe as si taktikë individuale zgjedhore.

9. Kandidatët që regjistrohen në zgjedhje regjistrohen për të marrë pjesë në garë. Praktika zgjedhore mund të njohë raste kur kandidatë të veçantë mund të mos zhvillojnë dot veprimtari fushate, por ky rast mund të pranohet vetëm si rast përjashtimor dhe që vjen për shkaqe madhore.

10. Një nga kushtet e vendosura për subjektet zgjedhore për të marrë pjesë është ai i plotësimin të listave shumëemërore në bazë qarku. Neni 67 i Kodit Zgjedhor kërkon që “numri i

kandidatëve në listën shumëemërore nuk mund të jetë më i vogël se numri i mandateve që do të zgjidhen në zonën zgjedhore përkatëse, shtuar dy”. Ky kusht i shërben ruajtjes në çdo rast të funksionalitetit të organit të zgjedhur dhe garantimit të paritetit gjinor. Ky kusht përbën *conditio sine qua non* për partinë politike që kërkon të marrë pjesë në garë. Por kjo nuk do të thotë, se kushti mund të anashkalohet duke dorëzuar lista kandidatësh jo reale, të mbushur me emra individësh që nuk e ndjejnë, nuk duan ose që nuk kanë nevojë të marrin pjesë në garë. Plotësimi fiktiv i listave të kandidatëve, me qëllimin që një ose disa kandidatë të marrin pjesë në garë me formatin e një partie politike është praktikë e kundërligjshme zgjedhore, sepse cënon parimin e konkurrueshmërisë dhe barazinë e palëve në garë.

11. Kandidimi i një ose disa kandidatëve të së njëjtës përkatësi është i mundur sipas Kodit Zgjedhor, pa pasur nevojë për plotësimin formal/fiktiv të kushtit të nenit 67 të Kodit për numrin e kandidatëve në listë. Ai realizohet me mekanizimin e kandidatëve të pavarur, për të cilët veprojnë kushte dhe kriteret të tjera. Nëse një parti e vogël politike zgjedh me vetëdije konkurrimin si parti në zgjedhje, atëherë ajo duhet të pranojë dhe respektojë të gjitha kushtet dhe kriteret e vendosura nga Kodi për partitë politike, përndryshe i takon të përballet me pasojat që Kodi ka parashikuar për kundravajtjen.

12. Për këto arsye, KAS-i e gjen me vend që t'a rrëzojë pretendimin e paraqitur për mosraportim të kandidatëve “për shkak se nuk kanë pasur shpenzime, ngaqë nuk kanë bërë fushatë”. Kandidimi fiktiv është në kundërshtim të hapur me qëllimin e zgjedhjeve dhe parimet mbi të cilat zhvillohen ato, prandaj KAS-i nuk mund ta legjitimojë këtë praktikë.

13. Pretendimi tjetër i rëndësishëm ishte pretendimi i ngritur nga një pjesë e palëve të interesuara, se, sa i takon koalicionëve, detyrimet dhe përgjegjësitë për raportimin i takojnë partisë udhëheqëse të koalicionit dhe partitë pjesëmarrëse në koalicion nuk mund të penalizohen për mangësi në raportim, sa kohë që për to mungon detyrimi për raportim. Partia udhëheqëse e koalicionit duhet të përgjigjet përpara KQZ-së dhe eventualisht të penalizohet për mospërmbyllje të detyrimeve në raportim, në emër dhe për llogari të të gjitha partive pjesëmarrëse.

14. Pretendimi mbështetëj në leximin, nga ky pozicion, të fjalisë së dytë të pikës 3, të nenit 65 të KZ: “Për nevojat e zbatimit të këtij ligji, të gjitha të drejtat dhe detyrimet që ky ligj përcakton për subjektet zgjedhore përmbylljen nga partia udhëheqëse e koalicionit”.

15. Çështja e transferimit të të drejtave dhe detyrimeve tek partia udhëheqëse e koalicionit është trajtuar nga KAS-i në vendimin e tij nr. 20, datë 05.04.2021 dhe nga Kolegji Zgjedhor Gjyqësor të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve në vendimin e tij nr.8, datë 19.04.2021. Këto vendime kanë pasur në fokus të drejtën e partisë politike pjestare të koalicionit për të propozuar anëtarët e GNV-ve. Në këtë rast, si KAS-i ashtu dhe KZGJ-ja kanë mbështetur leximin, se qenia e një partie pjestare në një koalicion e zhvesh atë nga të drejtat dhe detyrimet që i takojnë sipas Kodit Zgjedhor. “Detyrimi i vendosur nga neni 65, paragrafi 3 i Kodit Zgjedhor nuk mund të konsiderohet i përmbyllur vetëm me përcaktimin e një partie udhëheqëse të koalicionit, nëse kjo parti nuk do të kishte një “status të veçantë” në krahasim me partitë e tjera. Pra, me vullnetin e tyre të lirë partitë politike zgjedhin mes tyre atë udhëheqëse, në mënyrë që kjo e fundit të ushtrojë në emër dhe për interes të të gjitha partive pjesëmarrëse të koalicionit, të drejtat dhe detyrimet që i njihen çdo subjekti politik pjesëmarrës në zgjedhje” (Vendimi i KAS-it nr. 20, datë 05.04.2021).

16. Përtej qëndrimit të mbajtur me vendimin nr.20, datë 05.04.2021, KAS-i konstaton se detyrimi për raportimin financiar nuk formon një rregullim sui generis në Kodin tonë Zgjedhor, i cili të përjashtojë zbatimin e paragrafit 3, të nenit 65 në rastin e raportimit financiar. Thënë

këtë, KAS-i çmon se vendimi i tij nr. 20, datë 05.04.2021 ka nevojë të rivizitohet në rastin objekt shqyrtimi, me qëllim që të shmangen keqkuptimet, të sqarohet më mirë pozita juridike e partisë udhëheqëse dhe e partisë pjesëmarrëse në koalicion, si dhe të ndahen saktësisht përgjegjësitë.

17. Qëllimi i paragrafit 3 të nenit 65 të Kodit Zgjedhor nuk është përcaktimi i një pozite të privilegjuar të partisë udhëheqëse të koalicionit në raport me partitë pjesëmarrëse të tij. Fjalja “për nevojat e zbatimit të këtij ligji, të gjitha të drejtat dhe detyrimet që ky ligj përcakton për subjektet zgjedhore përmbushen nga partia udhëheqëse e koalicionit” ka qëllim vetëm të përcaktojë partinë udhëheqëse të koalicionit si pikë kontakti dhe interlokutor të KQZ-së, në emër dhe për llogari të koalicionit. Nuk është qëllim i Kodit dhe nuk ka kuptim që të pretendohet se themelimi i koalicionit “asgjëson” partitë pjesëmarrëse të tij (të drejtat e tyre) dhe mban në këmbë vetëm partinë udhëheqëse. Partitë pjesëmarrëse konkurrojnë në zgjedhje, sikurse bën edhe partia udhëheqëse. Të drejtat dhe detyrimet e tyre nuk shuhen.

18. Transferimi i të drejtave dhe detyrimeve nga partitë pjesëmarrëse tek partia udhëheqëse nuk vjen për shkak të fjalisë së dytë të paragrafit 3 të nenit 65, nuk vjen ipso lege, por vjen për shkak të fjalisë së tretë të tij, e cila përcakton se “marrëdhëniet midis partive pjesëtare të koalicionit dhe detyrimet reciproke midis tyre rregullohen në marrëveshjen e koalicionit, e cila është pjesë e dokumentacionit që depozitohet nga koalicioni në KQZ”. Është marrëveshja e koalicionit ajo që bën transferimin e të drejtave dhe detyrimeve tek partia udhëheqëse. Për këtë shkak, marrëveshja e koalicionit duhet të formojë jo vetëm autorizimin për partinë udhëheqëse të koalicionit për përfaqësim, por duhet edhe të vendosë modalitetet, procedurat dhe kufijtë e këtij përfaqësimi, duhet të vendosë përgjegjësitë dhe detyrimet e partisë udhëheqëse ndaj partive pjesëmarrëse në koalicion. Vetëm mbi këtë bazë mund të kryhet ushtrimi “në emër dhe për llogari” i të drejtave dhe përmbushja “në emër dhe për llogari” e detyrimeve nga ana e partisë udhëheqëse të koalicionit.

19. Fjalja e dytë dhe fjalja e tretë e paragrafit 3, të nenit 65 janë të pandashme dhe në unitet me njëra tjetrën. Është ky unitet që bën të mundur që të drejtat dhe detyrimet e partive pjesëmarrëse në koalicion të mos shuhen. Ato mund të transferohen tek partia udhëheqëse e koalicionit, por që ky transferim të jetë detyruar për KQZ-në, ai duhet të jetë i shprehur qartë dhe pa ekuivoke në marrëveshjen e koalicionit.

20. Praktika zgjedhore e palëve të interesuara, të cilat në zgjedhjet e datës 25 Prill 2021, kanë qenë të inkuadruara në koalicione është zhvilluar nëpërmjet marrëveshjeve të koalicionit tejet lakonike, të cilat kanë pasqyruar dakordësinë për ekstremitetet e koalicionit (emërtimi, partitë pjesëmarrëse, autorizimi i përfaqësimit), por nuk kanë rregulluar në thelb marrëdhëniet midis partive pjesëmarrëse në koalicion, sidomos sa i takon të drejtave dhe detyrimeve ndaj njeri tjetrit dhe ndaj autoriteteve publike, modaliteteve dhe procedurave të përfaqësimit, raportimin dhe llogaaridhënien etj.

21. Kjo praktikë zgjedhore në lidhjen e marrëveshjeve të koalicionit nuk është në koherencë me përcaktimin e paragrafit 3, të nenit 65 të Kodit Zgjedhor dhe dëmton jo vetëm sjelljen në përputhje me ligjin të partive udhëheqëse dhe të partive pjesëmarrëse në koalicione, por edhe pengon zbatimin harmonik dhe pa konflikte të brendshme të detyrimeve ligjore nga koalicionet, në zgjedhje dhe rreth tyre.

22. KAS-i e sheh ligjërisht të mundur dhe i rekomandon KQZ-së, që në ndihmë të subjekteve zgjedhore dhe në zbatim të kompetencës për unifikimin e praktikës zgjedhore të hartojë udhëzime ndihmëse të detajuara për lëndën që duhet të mbulojnë marrëveshjet e koalicionit, me qëllim që ato të jenë ezauruese dhe në harmoni me paragrafin 3, të nenit 65 të Kodit Zgjedhor, pa

ndërhyrë në lirinë e partive politike që të përcaktojnë vetë konturet e bashkëpunimit në koalicion.

23. Duke e parë praktikën zgjedhore të koalicioneve nga këndvështrimi i çështjes objekt shqyrtimi konstatohet lehtë se në ak marrëveshjet e bashkëpunimit midis Komisionerit dhe partive politike që përfitonin financim buxhetor në zgjedhje (shih vendimin e Komisionerit nr. 172, datë 23.03.2021), këto të fundit i pranonin fondet kundrejt zotimit për t'i përdorur ato "në zbatim të të gjitha kushteve dhe detyrimeve të përcaktuara në ligjin nr.10019, datë 28.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar" (pika 1, e nenit 3 të ak marrëveshjes tip). Në mënyrë të shprehur ato zotoheshin të respektonin "të gjitha ndalimet dhe kufizimet" që përcaktohen në Kodin Zgjedhor (pika 3, e nenit 3 të akt marrëveshjes tip), si dhe pranonin "auditimin e fondeve dhe të shpenzimeve të fushatës zgjedhore sipas nenit 92/6 të Kodit Zgjedhor, si dhe monitorimin e aktivitetit gjatë fushatës zgjedhore dhe 4 muaj para datës së zgjedhjeve sipas nenit 92/4 të Kodit Zgjedhor, pavarësisht faktit nëse regjistrohen më vete si subjekt zgjedhor apo në kuadër të një koalicioni zgjedhor" (neni 6 i ak marrëveshjes tip).

24. Asnjë nga këto zotime nuk ndodhen të transkriptuara në marrëveshjet e koalicionit të lidhura në kuadër të zgjedhjeve të datës 25 Prill 2021. Në vlerësimin e KAS-it, kjo do të thotë se palët nuk kanë pasur qëllim dhe nuk kanë realizuar në fakt transferimin e këtyre detyrimeve/zotimeve nga partitë pjesëmarrëse tek partia udhëheqëse dhe se pretendimi i shprehur në seancë përpara KAS-it se përgjegjësia për raportimit duhet të mbetet me partinë udhëheqëse të koalicionit nuk ka bazë ligjore.

25. Ky pretendim rrëzohet edhe nga analiza kronologjike e ngjarjeve. Partitë politike pjesëtare në koalicione janë sjellë si mbartëse të detyrimit përgjatë gjithë hapave të procesit të raportimit dhe e kanë ngritur pretendimin vetëm në fund të tij, në momentin kur janë mbajtur përgjegjëse për shkelje ose mangësi në raportim.

26. Subjekti zgjedhor "Partia Republikane", për të cilin Komisioneri ka kërkuar vendosjen e sanksionit administrativ për shkak se "nuk ka dorëzuar raportin për 1 (një) kandidat të listave shumëemërore" provoi në seancë se kishte bërë përpjekje të qarta dhe të besueshme si kundrejt kandidatit Lodovik Hasani, ashtu dhe kundrejt partisë udhëheqëse të koalicionit, për të vënë kandidatin përpara detyrimit për dorëzimin e raportit. Përpjekjet e subjektit zgjedhor nuk patën rezultat pozitiv.

27. Pika 4 e nenit 90 të Kodit Zgjedhor përcakton se "subjekti zgjedhor mban përgjegjësi sipas këtij ligji për shkeljen e kushteve dhe detyrimeve lidhur me financimin nga ana e kandidatëve të vet, me përjashtim të rastit kur nga hetimi administrativ vërtetohet se subjekti zgjedhor nuk ka pasur mundësi ose, me gjithë përpjekjet e bëra, nuk ka arritur dot të parandalojë ose korrigjojë shkeljen e kryer nga kandidati. Në këtë rast përgjegjësia administrative dhe penaltetet për shkeljen i ngarkohen kandidati".

28. KAS-i e gjen të provuar verifikimin e rastit përjashtimor që parashikon pika 4, e nenit 90 të KZ në rastin e Partisë Republikane dhe vendosi t'ia ngarkojë përgjegjësinë administrative kandidatit Lodovik Hasani. KAS-i çmon se sanksioni ndaj kandidatit duhet të mbahet në minimumin ligjor, për të priorizuar qëllimin edukativ të masës administrative në këtë rast.

29. Subjektet zgjedhore Partia Socialiste, Partia Demokratike, Lëvizja për Zhvillim Kombëtar, Lëvizja e Legalitetit, Bashkimi Popullor i Pensionistëve Shqiptarë, Nisma Thurje, Bindja Demokratike, Partia Socialdemokrate dhe Balli Kombëtar rezultojnë e provuar se kanë pasur mungesa në raportimin e kandidatëve të tyre, të cilat shkojnë, sipas rastit, nga 1 (një), deri në 153 (njëqind e pesëdhjetë e tre) kandidatë. Komisioneri ka kërkuar për këto parti vendosjen e sanksionit. KAS-i çmon se kërkesa e Komisionerit duhet të pranohet dhe sanksioni të mbahet për



të gjitha subjektet në minimumin ligjor (pa proporcionalizuar masën), për të prioritetizuar qëllimin edukativ të masave administrative në këtë rast.

30. Komisioneri ka konstatuar se Partia Demokratike e Shqipërisë dhe Lëvizja për Zhvillim Kombëtar kanë deklaruar shpenzime, për të cilat në një masë të caktuar nuk disponojnë dokumentacionin justifikues. Për këtë arsye Komisioneri ka kërkuar vendosjen e sanksionit administrativ. KAS-i çmon se kërkesa e Komisionerit duhet të pranohet dhe sanksioni të mbahet për këto subjekte në minimumin ligjor (pa proporcionalizuar masën), për të prioritetizuar qëllimin edukativ të masave administrative në këtë rast”.

#### **11. Pala paditëse Partia Lëvizja për Zhvillim Kombëtar (PLZHK) në kërkesëpadi dhe gjatë gjyqimit, nëpërmjet përfaqësuesi të tij, ka pretenduar se:**

- PLZHK e kundërshton këtë vendim si të pabazuar në ligj dhe në fakt sepse vërtetë Kodi Zgjedhor kërkon dhe ngarkon me detyrimin për të paraqitur raportet financiare të kandidatit të saj partinë politike por:

- Kur kandidatët provohet të kenë kryer shpenzime dhe të kenë siguruar të ardhura dhe partia politike nuk i ka deklaruar këto shpenzime dhe të ardhura. Propozimi i Komisionerit për gjobitjen e Partisë Lëvizja për Zhvillim Kombëtar është bërë me arsyetimin se kjo parti nuk ka deklaruar shpenzimet dhe të ardhurat e kandidatëve pa vërtetuar se ata kanë bërë të tilla dhe nuk janë deklaruar. Shkelja në këtë rast është vetëm për mosplotësim të kërkesës formale për deklarim, jo se është vërtetuar se kandidati jone ka bërë shpenzime dhe ato janë mbajtur të fshehta prej tyre dhe prej Partisë Lëvizja për Zhvillim Kombëtar. Ky është një arsyetim dhe interpretim i gabuar i ligjit, se vërtetë ligji ngarkon me detyrën e deklarimit të shpenzimeve dhe të ardhurave të kandidatëve të saj partinë politike, por kjo vetëm në rastin kur kandidatët kanë bërë shpenzime dhe ato janë mbajtur të fshehta, jo kur jemi para rastit që kandidati nuk ka bërë asnjë shpenzim të deklarueshëm dhe nuk provohet se kanë pasur ndonjë të ardhur. Në këtë rast këto deklarime mungojnë sepse nuk ka pasur se çfarë të deklarohet.

- Kodi është i qartë kur përcakton se:

Neni 78, Të drejtat dhe detyrimet e subjekteve zgjedhore gjatë fushatës (Ndryshuar me ligjin nr.74/2012, datë 19.7.2012 dhe me ligjin nr. 101/2020, datë 23.7.2020).

1. Gjatë fushatës zgjedhore çdo subjekt zgjedhor ka të drejtë të bëjë propagandë zgjedhore në çdo mënyrë të ligjshme. 2. Marrëdhëniet e subjekteve zgjedhore me operatorët radiotelevizivë për 39 transmetimin e veprimtarive të fushatës, mesazheve apo reklamave zgjedhore të subjektit u nënshtrohen rregullave, kushteve dhe kufizimeve të përcaktuara në këtë ligj. 3. Rregullat, kushtet dhe kufizimet e përcaktuara në këtë ligj kanë qëllim garantimin e barazisë së subjekteve zgjedhore në garë, sigurimin e paanësisë së operatorëve radiotelevizivë në raport me fushatën dhe subjektet e veçanta zgjedhore, si dhe mbrojtjen e subjekteve zgjedhore nga praktikat e deformimit të mesazhit zgjedhor, censurës dhe përdorimit të kundërligjshëm të medias. 4. Rezultatet e sondazheve zgjedhore nuk mund të publikohen gjatë 5 ditëve të fundit para datës së zgjedhjeve, përfshirë edhe datën e zgjedhjeve deri në orën e mbylljes së votimit. 5. Publikimi i rezultateve të sondazheve zgjedhore duhet të përfshijë edhe emrin e organizatorit të sondazhit, porositesin e tij, numrin e personave të intervistuar, probabilitetin e gabimit, si dhe periudhën e zhvillimit të sondazhit. 6.

Ndalohet zhvillimi i fushatës zgjedhore në institucionet publike. 7. Subjekteve zgjedhore dhe kandidatëve u ndalohet dhe mbajnë përgjegjësi penale në rast se ofrojnë ose japin të holla, të mira materiale, premtojnë për vend pune ose favorizime të tjera në cilëndo formë për zgjedhësin ose persona të tjerë të lidhur me të, me qëllim marrjen e firmës për paraqitjen e një kandidati në zgjedhje, për të votuar në një mënyrë të caktuar, për të marrë pjesë ose jo në votime, ose për t'u angazhuar në veprimtari të paligjshme për mbështetjen e një kandidati ose partie politike. 8. Subjektet zgjedhore dhe kandidatët e tyre nëpërmjet subjekteve zgjedhore bartin detyrimin për transparencë të të ardhurave dhe shpenzimeve, sipas rregullave të këtij ligji dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij. 9. Subjekteve zgjedhore dhe kandidatëve u ndalohet të organizojnë, kryejnë apo mbulojnë shpenzimet vetë ose nëpërmjet të tretëve për koncerte, shfaqje kulturore argëtuese apo veprimtari bamirësie, pavarësisht nëse ato mbahen përgjatë ose në lidhje me tubimet elektorale, apo zhvillohen si veprimtari fushate ose jashtë saj. 10. Nuk përbën shkelje dhe subjektet zgjedhore dhe kandidatët lejohet të ofrojnë sende dhe materiale të printuara fushate kur vlera e tyre është më e vogël se pesë qind lekë për send ose material. KQZ-ja mban dhe përditëson listën e sendeve apo materialeve të lejuara për fushatë, me vlerat maksimale për secilin prej tyre.

Neni 92/3 Deklarimi dhe publikimi 1. Subjektet zgjedhore janë të detyruara të paraqesin raport financiar për fushatën zgjedhore në KQZ brenda 60 ditëve nga shpallja e rezultatit të zgjedhjeve. 2. Raportet financiare hartohen sipas modeleve të miratuara nga KQZ-ja. Raporti, si rregull, duhet të përmbajë informacion, për: a) çdo dhurim, hua ose kredi që i është dhënë subjektit zgjedhor (duke përfshirë edhe degët dhe kandidatët e tij) gjatë fushatës zgjedhore dhe gjashtë muaj para fushatës dhe burimin e tij, përfshirë edhe dhurimet apo shërbimet në natyrë; b) të ardhurat për qëllime të fushatës zgjedhore nga të gjitha burimet e tjera të lejuara; c) të gjithë zërat e shpenzimeve për qëllime të fushatës zgjedhore siç përcaktohen në vendimin e KQZ-së dhe në pikën 4 të nenit 92/2 të këtij ligji; ç) bilancin e asetëve dhe detyrimeve të partisë politike për periudhën nga dekretimi i datës së zgjedhjeve deri në datën e zgjedhjeve. 3. Çdo parti politike që merr pjesë në zgjedhje mban dhe ruan në arkiv për një periudhë prej 7 vjetësh dokumentacionin e plotë dhe të hollësishëm të statusit të saj financiar dhe të degëve të saj për periudhën që mbulon ky raport, duke përfshirë: a) librat e llogarive/kontabilitetit, mbajtur në përputhje me legjislacionin në fuqi, ku pasqyrohen të gjitha të ardhurat sipas burimit dhe shumës, identifikohet si është bërë pagesa, si dhe pagesat e bëra personave të tretë, qëllimet e pagesave dhe se si është kryer çdo pagesë; b) dokumentacionin e të gjitha shpenzimeve të bëra; c) situatën dhe lëvizjet në llogarinë e saj bankare; ç) dokumentacionin e plotë të pronave të paluajtshme që zotëron partia politike, si dhe çdo kontratë të lidhur për marrje me qira, dhënie me qira, porositje apo shitje të pronave të luajtshme dhe të paluajtshme; d) regjistrin e dhuruesve, huadhënësve dhe kredidhënësve, sipas modelit të përcaktuar në pikën 1 të nenit 92/2.

- Nga parashikimet ligjore partia politike ka për detyrim të deklarojë shpenzimet dhe të ardhurat e çdo forme të kandidatëve të saj, por nuk ngarkohet me detyrim për të deklaruar shpenzime apo të ardhura të kandidatëve kur ata nuk kanë pasur të tilla. Propozimi i Komisionerit nuk provon se kandidati i Lëvizjes për Zhvillim Kombëtar ka realizuar shpenzime apo ka siguruar të ardhura për fushatën elektorale dhe këto

shpenzime e të ardhura nuk janë deklaruar nga partia në këtë rast. Ai kërkon ndëshkimin e partisë politike apriori vetëm pse nuk ka një formular deklarimi për shpenzimet dhe të ardhurat e secilit kandidat, pa provuar dhe pa pretenduar se këta kandidatë kanë pasur shpenzime dhe të ardhura.

- Partia Lëvizja për Zhvillim Kombëtar ka përmbushur këtë detyrim ligjor sepse ka paraqitur në faqen e fundit të modelit të raportimit në KQZ, ku kërkohej raportimi i shpenzimeve të kandidatëve, shpenzimin e kandidatit tonë, që në këtë rast ka qenë 0 lekë.

Sikurse edhe disa prej rubrikave të tjera të formatit të KQZ janë plotësuar me vlerën 0 për shkak se nuk kemi pasur asnjë gjë për të raportuar për atë rubrikë, kështu ka ndodhur dhe në rastin e kandidatëve të cilët partia i ka deklaruar me shpenzime 0 lekë.

- Në sqarimin e propozimit të Komisionerit për gjobitje, sekretari i përgjithshëm i KQZ ka deklaruar se gjoba është marrë për shkak të mosdeklarimit të shpenzimeve të kandidatit të LZHK dhe jo se administrata e KQZ ka vërtetuar shpenzime të padeklaruar nga këta kandidatë. Në këto kushte deklarimi prej 0 shpenzime nga ana e kandidatit të LZHK në faqen e fundit të formularit tip të deklarimit të shpenzimeve të Partisë Bindja Demokratike për zgjedhjet e 2021, plotëson kërkesën ligjore dhe rrezon pretendimin e shkeljes nga ana e KAS se kandidatët e Bindjes Demokratike nuk kanë përmbushur detyrimin për deklarimin e shpenzimeve të tyre në fushatë elektorale. Deklarimi me 0 lekë shpenzime dhe të ardhura për kandidatët tanë në thelb është një deklaram që përmbush kërkesën formale për deklaram. Pavarësisht se në këtë rast deklarimi është bërë me 0 lekë shpenzime dhe të ardhura, ai është një deklaram i rregullt sepse pasqyron të vërtetën.

- Fakti që në raportin financiar të dorëzuar nga LZHK shpenzimet e kandidatëve të saj janë deklaruar me zero, nuk do të thotë se të gjithë kandidatët tanë nuk kanë bërë asnjë shpenzim financiar për fushatën e tyre elektorale, por sepse siç u sqarua edhe në mbledhjen e KAS, Lëvizja për Zhvillim Kombëtar, për të lehtësuar deklarimin e shpenzimeve të saja financiare, të gjitha shpenzimet i ka deklaruar nëpërmjet deklarimit të shpenzimeve të Partisë. Kjo ka ndodhur në këtë mënyrë: Kandidati jone të gjithë kontributin financiar që kishte planifikuar të shpenzonte për fushatë e ka derdhur pranë arkës së Partisë. Me pas çdo shpenzim financiar që ka pasur për fushatën e tyre e ka bërë duke tërhequr lekët pranë arkës së LZHK. Pra në këtë rast çdo shpenzim i kandidatit është bërë nga arka e LZHK dhe është deklaruar si shpenzim i partisë. Kjo për të lehtësuar raportimin sa më të saktë e të plotë të shpenzimeve në fushatë.

- Në këtë deklaram të partisë LZHK përfshiheshin të gjitha shpenzimet financiare dhe në natyrë që janë të detyrueshme të deklarohen në këtë rast. Sa i përket pretendimit të KAS se është e pamundur që një kandidat të mos ketë asnjë shpenzim në fushatë sqarojmë se ky arsyetim nuk është i saktë sepse, KAS konsideron shpenzime edhe ato shpenzime të cilat janë të padeklarueshme në këtë rast. Shpenzimet e deklarueshme sipas Kodit Zgjedhor dhe akteve të tjera nënligjore janë dy lloje, ose financiare ose në formën e kontributit në natyrë. Të gjitha shpenzimet e tjera nuk janë të deklarueshme sepse nuk përfshihen as në shpenzime financiare dhe as në shpenzime në natyrë.

- Për të gjitha këto arsye, KAS në vendimin e tij nr. 7 datë 25.01.2023 ka disponuar në kundërshtim me ligjin dhe provat. Përfundimisht kërkojmë nga Kolegji Zgjedhor

pranimin e ankimit dhe ndryshimin e vendimit të KAS duke vendosur rrezimin e kërkesës së Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.

## **12.Pala e paditur Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, nëpërmjet përfaqësuesit të tij, gjatë gjykimit ka pretenduar se:**

- Së pari: Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve nuk ka vërtetuar nëse kandidatët e Lëvizjes për Zhvillim Kombëtar kanë bërë shpenzime dhe janë mbajtur të fshehta nga ana e kandidatëve.
- Së dyti: Partia Lëvizja për Zhvillim Kombëtar ka përmbushur detyrimin ligjor pasi ka paraqitur në faqen e fundit të modelit të raportimit në KQZ, ku kërkohej raportimi i shpenzimeve të kandidatëve.
- Së treti: Shpenzimet e bëra nga kandidatët e Lëvizja për Zhvillim Kombëtar, për lehtësim e deklarimeve të shpenzimeve financiare, të gjitha shpenzimet janë deklaruar nëpërmjet deklarimit të shpenzimeve të Partisë, me qëllim lehtësimin e raportimit sa më të saktë dhe të plotë të shpenzimeve gjatë fushatës zgjedhore.
- Së katërti: Në deklarimin e bërë nga partia LZHK, përfshihen të gjitha shpenzimet financiare dhe në natyrë që janë të detyrueshme të deklarohen në këtë rast.
- Në vendimin nr. 224, datë 07.12.2022 “Për miratimin e raportit të gjetjeve nga auditimi i fondeve të përfituara dhe shpenzuara nga partitë politike pjesëmarrëse në zgjedhjet 2021” të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, në raportin financiar të dorëzuar jo në përputhje me ligjin dhe aktet nënligjore, rezultoi se:  
“Lëvizja për Zhvillim Kombëtar”  
Nuk ka dorëzuar raportin për 1 (një) kandidat të listave shumëemërore duke mos respektuar vendimin nr. 13, datë 6 prill 2021, të Komisionit Rregullator dhe për këtë arsye nuk janë audituar raportet e kandidatëve. Referuar nenit 173, pika 3, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar .....  
“Paraqitja e raporteve në shkelje të rregullave dhe formateve të standardizuara të miratuara nga KQZ-ja dënohet me gjobë në vlerën 500.000 (pesëqind mijë) deri 1 000 000 (një milion) lekë;
- Ka kryer shpenzime për fushatën pa dokumentacion justifikues në shumën prej 325.000 leke, prej të cilave 150.000 lekë janë pa paguar akoma. Referuar nenit 173, pika 1, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, “... Shkelja e dispozitave për financimin e fushatës zgjedhore nga personi përgjegjës i financës së një partie politike dënohet me gjobë në vlerën 100 000 (njëqind mijë) deri në 200 000 (dyqind mijë) lekë.
- Së pari, KAS-i çmon se pretendimi për fushatë të kandidatëve “pa shpenzime” është një pretendim jo real, i cili mund të vijë nga padija, paaftësia për të ruajtur disiplinë financiare apo për të organizuar siç duhet punën, por mund të vijë edhe si tentativë për mosraportim të saktë, për fshehje apo devijim të një pjese të të ardhurave dhe shpenzimeve në kanale informale, apo si shmangie nga tavanet ligjore etj. Pavarësisht nga motivet, pretendimi për kandidatë “pa shpenzime” nuk mund të pranohet nga KAS-i, sepse një pretendim i tillë është de facto i pavërtetë.
- Së dyti, çështja e transferimit të të drejtave dhe detyrimeve tek partia udhëheqëse e koalicionit është trajtuar nga KAS-i në vendimin e tij nr. 20, datë 05.04.2021 dhe nga Kolegji Zgjedhor Gjyqësor në vendimin e tij nr.8, datë 19.04.2021. Në këtë rast, si KAS-i

ashtu dhe KZGJ-ja kanë mbështetur leximin, se qenia e një partie pjesëtare në një koalicion e zhvesh atë nga të drejtat dhe detyrimet që i takojnë sipas Kodit Zgjedhor. “Detyrimi i vendosur nga neni 65, paragrafi 3 i Kodit Zgjedhor nuk mund të konsiderohet i përmbushur vetëm me përcaktimin e një partie udhëheqëse të koalicionit, nëse kjo parti nuk do të kishte një “status të veçantë” në krahasim me partitë e tjera. Pra, me vullnetin e tyre të lirë partitë politike zgjedhin mes tyre atë udhëheqëse, në mënyrë që kjo e fundit të ushtrojë në emër dhe për interes të të gjitha partive pjesëtare të koalicionit, të drejtat dhe detyrimet që i njihen çdo subjekti politik pjesëmarrës në zgjedhje”.

- Transferimi i të drejtave dhe detyrimeve nga partitë pjesëmarrëse tek partia udhëheqëse nuk vjen për shkak të fjalisë së dytë të paragrafit 3, të nenit 65, por vjen për shkak të fjalisë së tretë të tij, e cila përcakton se “marrëdhëniet midis partive pjesëtare të koalicionit dhe detyrimet reciproke midis tyre rregullohen në marrëveshjen e koalicionit, e cila është pjesë e dokumentacionit që depozitohet nga koalicioni në KQZ”. Është marrëveshja e koalicionit ajo që bën transferimin e të drejtave dhe detyrimeve tek partia udhëheqëse. Për këtë shkak, marrëveshja e koalicionit duhet të formojë jo vetëm autorizimin për partinë udhëheqëse të koalicionit për përfaqësim, por duhet edhe të vendosë modalitetet, procedurat dhe kufijtë e këtij përfaqësimi, duhet të vendosë përgjegjësitë dhe detyrimet e partisë udhëheqëse ndaj partive pjesëmarrëse në koalicion. Vetëm mbi këtë bazë mund të kryhet ushtrimi “në emër dhe për llogari” i të drejtave dhe përmbushja “në emër dhe për llogari” e detyrimeve nga ana e partisë udhëheqëse të koalicionit.
- Duke e parë praktikën zgjedhore të koalicioneve nga këndvështrimi i çështjes objekt shqyrtimi konstatohet lehtë se në aktmarrëveshjet e bashkëpunimit midis Komisionerit dhe partive politike që përfitonin financim buxhetor në zgjedhje (shih vendimin e Komisionerit nr. 172, datë 23.03.2021), këto të fundit i pranonin fondet kundrejt zotimit për t’i përdorur ato “në zbatim të të gjitha kushteve dhe detyrimeve të përcaktuara në ligjin nr.10019, datë 28.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar” (pika 1, e nenit 3 të aktmarrëveshjes tip). Në mënyrë të shprehur ato zotoheshin të respektonin “të gjitha ndalimet dhe kufizimet” që përcaktohen në Kodin Zgjedhor (pika 3, e nenit 3 të aktmarrëveshjes tip), si dhe pranonin “auditimin e fondeve dhe të shpenzimeve të fushatës zgjedhore sipas nenit 92/6 të Kodit Zgjedhor, si dhe monitorimin e aktivitetit gjatë fushatës zgjedhore dhe 4 muaj para datës së zgjedhjeve sipas nenit 92/4 të Kodit Zgjedhor, pavarësisht faktit nëse regjistroheshin më vete si subjekt zgjedhor apo në kuadër të një koalicioni zgjedhor” (neni 6 i aktmarrëveshjes tip).
- Asnjë nga këto zotime nuk ndodhen të transkriptuara në marrëveshjet e koalicionit të lidhura në kuadër të zgjedhjeve të datës 25 Prill 2021. Në vlerësimin e KAS-it, kjo do të thotë se palët nuk kanë pasur qëllim dhe nuk kanë realizuar në fakt transferimin e këtyre detyrimeve/zotimeve nga partitë pjesëmarrëse tek partia udhëheqëse dhe se pretendimi i shprehur në seancë përpara KAS-it se përgjegjësia për raportimin duhet të mbetet me partinë udhëheqëse të koalicionit nuk ka bazë ligjore.
- Ky pretendim rrëzohet edhe nga analiza kronologjike e ngjarjeve. Partitë politike pjesëtare në koalicione janë sjellë si mbartëse të detyrimit përgjatë gjithë hapave të procesit të raportimit dhe e kanë ngritur pretendimin vetëm në fund të tij, në momentin kur janë mbajtur përgjegjëse për shkelje ose mangësi në raportim.

- Për sa më sipër, KQZ kërkoi rrëzimin e kërkesëpadisë dhe lënien në fuqi të vendimit nr. 07, datë 25.01.2023 të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve “Për shqyrtimin e kërkesës nr. 04, datë 14.12.2022 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve”.

## **II. ARSYETIMI I KOLEGJIT:**

13. Në vlerësim të Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor, konstatohet se pas përfundimit të zgjedhjeve të prillit 2021, në zbatim të Kodit Zgjedhor, KQZ, ka ndërmarrë veprimet audituese të fondeve të përfituara dhe të shpenzuara për fushatën zgjedhore. Auditimi si procedurë paraqet domosdoshmëri për transparencë dhe sa më lart merr vlerë të veçantë, kur bëhet fjalë për auditimin financiar të fondeve që përfitohen dhe shpenzohen gjatë një fushate zgjedhore. Nëpërmjet auditimit, evidentohen të dhëna që nxjerrin në pah aspekte të fushatës zgjedhore, nga pikëpamja e përdorimit/shpenzimit të fondeve. Që procesi i auditimit të kryhet sipas ligjit, është e nevojshme, që informacioni që i vihet në dispozicion audituesve të jetë i besueshëm, i verifikueshëm, i rëndësishëm dhe i raportuar në kohë. Pikërisht domosdoshmëria për transparencë në administrimin e financave, shtroi nevojën e fillimit të legjimitetit të shërbimeve të kontabilitetit dhe auditimit. Procesi i auditimit në vetvete synon të japë siguri objektive, të konstatohen gjetjet dhe në këtë mënyrë të mënjanojnë në të ardhmen problematikat. Auditimi si proces është i projektuar që të shtojë vlerat dhe të përmirësojë veprimtarinë financiare, që të përmbushen objektivat ligjore, në mënyrë që të konsolidohet një model i disiplinuar dhe efektiv dhe si rrjedhojë të menaxhohen rreziqet.

14. Auditimi është thelbësor për verifikimin e shpenzimeve financiare të subjekteve politike për fushatën zgjedhore. Qëllimi i auditimit është verifikimi i kontributeve, përdorimi i tyre në përputhje me ligjin. Nga ana tjetër, sigurimi i të dhënave nëpërmjet auditimit shërben edhe për informim publik mbi përdorimin e fondeve dhe kryerjen e shpenzimeve për fushatë zgjedhore, e gjitha kjo në kuadër të transparencës dhe rritjes së besimit. Vende të ndryshme kanë sisteme të ndryshme të auditimit financiar të subjekteve zgjedhore. Vendi ynë konstatohet që nëpërmjet edhe Kodit Zgjedhor ka përcaktuar qartazi procedurën që ndiqet nga ana e KQZ dhe njëkohësisht përcakton rregullat detyruese për subjektet politike/subjekte zgjedhore që auditohen, për të vënë në dispozicion informacionin, dokumentet apo të dhëna, çdo gjë që lidhet pikërisht me financimin e shpenzimet e fushatës zgjedhore (neni 92 i Kodit Zgjedhor). Duke parë dhe vlerësuar rëndësinë e auditimit financiar, mundësinë e sigurimit dhe ofrimit të informacionit nga subjektet zgjedhore, audituesve, Kodi Zgjedhor, ka përcaktuar gjithashtu se mosrespektimi i rregullave nga subjektet zgjedhore apo dhuruesit, (kuptohet në rast se nuk jemi përpara një veprë penale), përbën kundërvajtje të karakterit administrativ dhe rrjedhimisht pasohet me “ndëshkim”/sipas termit të përdorur në Kodin Zgjedhor, sipas parashikimeve të pjesës XIII të Kodit. Në vijim të përcaktimeve të Kodit Zgjedhor, konstatohet se në nenin 173/3 të tij parashikohet se: *“Mosparaqitja e një raporti financiar për fushatën brenda afatit ligjor dënohet me një gjobë..... Paraqitja e raporteve në shkelje të rregullave dhe formateve të standardizuara të miratuara nga KQZ-ja, dënohet me gjobë nga 500 000 deri 1 000 000 lekë”*.

15. Nga ana tjetër, Kolegji konstaton se në nenin 145 të Kodit Zgjedhor përcaktohet e drejta e subjekteve zgjedhore për të bërë ankime në Kolegjin Zgjedhor kundër vendimeve të KQZ-së, kur këto vendime çënojnë interesat e tyre të ligjshme, kuptohet brenda një afatit të caktuar. Në

kuptim të nenit 2/20 të Kodit Zgjedhor, “Subjekt zgjedhor konsiderohen partitë politike, koalicionet dhe kandidatët e propozuar nga zgjedhësit, si dhe kandidatët për kryetarë të organeve të qeverisjes vendore, të regjistruar në përputhje me këtë Kod”. Po kështu, sipas neni 2/28 të Kodit, shpenzime të fushatës zgjedhore konsiderohen të gjitha shpenzimet e bëra nga/ose në emër të një subjekti zgjedhor.....

16. Në rastin objekt shqyrtimi nga Kolegji, konstatohet se PLZHK, ka kundërshtuar vendimin e KAS, nëpërmjet të cilit, është disponuar për gjykitjen e këtij subjekti, sipas neneve 173.3 dhe 171.1 të Kodit Zgjedhor. Vendimi i KAS që kundërshtohet në rastin konkret, konstatohet nga Kolegji Zgjedhor Gjyqësor që kundërshtohet nga një subjekt politik, që ka marrë pjesë në procesin zgjedhor. Kjo parti PLZHK e kundërshton vendimin e KAS, me arsyetimin se të drejtat/interesat e saj janë çenuar nga kjo vendimmarrje e KAS. Në këtë kuptim, në interpretim të nenit 145 të Kodit Zgjedhor, vlerësohet nga kjo trupë gjyqësore e Kolegjit se ky i fundit është kompetent për shqyrtimin e kësaj padie, nisur edhe nga fakti se dispozita përkatëse e Kodit Zgjedhor (mbi kundravajtjen objekt shqyrtimi), nuk ka ndonjë parashikim tjetër specifik.

17. Vendimi i KAS është marrë mbi bazën e argumenteve se nuk ka dorëzuar raportin për 1 (një) kandidat të listave shumëemërore duke mos respektuar vendimin nr. 13, datë 6 prill 2021, të Komisionit Rregullator dhe për këtë arsye nuk janë audituar raportet e kandidatëve. Referuar nenit 173, pika 3, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”; si dhe ka kryer shpenzime për fushatën pa dokumentacion justifikues në shumën prej 325.000 leke, prej të cilave 150.000 lekë janë pa paguar akoma. Në këtë mënyrë, PLZHK nuk ka respektuar vendimin nr. 13, datë 6 prill 2021, të Komisionit Rregullator dhe për këtë arsye nuk janë audituar raportet e kandidatëve. Sipas Kodit Zgjedhor subjektet zgjedhore (kupto subjektet zgjedhore të procesit zgjedhor të përfunduar tashmë), detyrohen të paraqesin të gjithë informacionin, dokumentet, të dhëna që disponojnë për t`u verifikuar nga audituesit. Në situatën që ky informacion nuk paraqitet apo kur nuk plotësohen detyrimet ligjore për paraqitjen e të dhënave financiare, Kodi parashikon “ndëshkime” për subjektet, të përcaktuara në nenin 173 të Kodit Zgjedhor.

18. Kolegji vlerëson se për të konkluduar mbi bazueshmërinë ose jo të pretendimeve të ngritura në këtë çështje i referohet pretendimit të parashtruar edhe në KAS nga PLZHK se nuk ka pasur shpenzime nga kandidati.

19. Kolegji Zgjedhor Gjyqësor konsideron të drejtë arsyetimin e bërë nga KAS, lidhur me pretendimin mbi fushatë të kandidatëve “pa shpenzime”. Është e kuptueshme që një subjekt i cili garon në një proces elektorale, zhvillon dhe fushatë elektorale, e cila në vetvete mbart edhe shpenzime. Evidentimi i këtyre shpenzimeve dhe dhënia e këtij informacioni audituesit është shumë e rëndësishme. Për të evituar pikërisht fshehjen e shpenzimeve reale të kryera, është e nevojshme një raportim i saktë i shpenzimeve financiare, në atë masë që janë. Në këtë aspekt, nuk mund të shërbejë si shkak për mosparaqitje të raporteve financiare nga pala paditëse/partia përkatëse, pretendimi se nuk janë kryer shpenzime apo edhe se shpenzimet u kryen nëpërmjet partisë. Raportimi financiar është detyrim sipas Kodit Zgjedhor dhe ky detyrim, në interpretim të Kodit Zgjedhor i takon subjektit që merr pjesë në zgjedhje. Kolegji nxjerr këtë konkluzion në interpretim të dispozitave të Kodit Zgjedhor. Neni 92 e përcakton shumë qartë detyrimin e

subjekteve që do të garojnë në zgjedhje, për vënien në dispozicion të auditit, të informacioneve që lidhet me financimin dhe shpenzimet e fushatës zgjedhore.

Si përfundim, Kolegji e gjen të drejtë arsyetimin e KAS përsa i përket këtij pretendimi të paraqitura nga Partia LZHK dhe vlerëson se ky subjekt kishte detyrimin për raportimin financiar.

### **PËR KËTO ARSYE**

Kolegji Zgjedhor Gjyqësor, bazuar në nenin 158 të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë,

### **VENDOSI:**

- Rrëzimin e padisë.
- Shpenzimet gjyqësore siç janë bërë.
- Ky vendim është i formës së prerë dhe ndaj tij nuk lejohet ankim.

U shpall sot në Tiranë, më datë 09.03.2023.

**GJYQTARE**

**Esmeralda XHILI**

**GJYQTARE**

**Blerona HASA**

**GJYQTARE**

**Edlira PETRI  
(Kundër)**

**GJYQTARE**

**Manjola XHAXHO**

**GJYQTARE**

**Marsela DERVISHI**